



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: **“ALBPLAST ” sh.p.k**

Adresa: Elbasan , Bradashesh Ish- Nd Seleksionimit Metal.

1.1 Procedura e prokurimit: **“E HAPUR”** Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

1.2 Numri i referencës së procedurës/lotit : **REF-68516-05-11-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **” Blerje Tuba dhe Rakorderi”** me fond limit 67.323.117 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e treqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike ,

1.3 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.A.M.U sh.p.k

&

“NDREGJONI” sh.p.k

K14229210F

&

K11329048I

Vlera 56.940.680 (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

2.MUHOPLUS LTD sh.p.k

L52317046G

Vlera 61.929.117(gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë)lekë pa tvsh.

3.“ALBPLAST”sh.p.k

K73026210L

Vlera 62.336.661(gjashtëdhjetë e dy milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **A.M.U sh.p.k**

&

“NDREGJONI” sh.p.k

K14229210F

&

K11329048I

Vlera 56.940.680(pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në kushtet e veçanta të kualifikimit pika 2 d) ka kërkuar si më poshtë cituar:

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në DST njëri nga operatorët ekonomikë konkretisht operatori ekonomik A.M.U sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim debie nr.prot 1144,datë 16.04.2018 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuesit “A.M.U ” sh.p.k ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 16.04.2018 duke përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2018.

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht **muajin Prill 2018.**

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “

“A.M.U ” shpk, nuk plotësojnë Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasti kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 14.05.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 12.06.2018 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit **Prill 2018** si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasti kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri nga operatori ekonomik është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti A.K ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 3 si dhe 3.1 si më poshtë cituar:

3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017;
3.1.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik K.V.O konstaton se njëri nga operatorët ekonomikë përkatësisht A.M.U sh.p.k rezulton sipas ekstraktit të QKB ushtron aktivitet si dhe ka seli në adresën Durrës, Fushë Krujë, - Laç, km 1.5.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 të lëshuar në këtë rast nga Autoriteti përkatës i cili sipas QKB i përket Bashkisë Fushë-Krujë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e

percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e percaktuara në dokumentet e tenderit.

2.”MUHOPLUS LTD” sh.p.k

L52317046G

Vlera 61.929.117 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik 2.3.8 si më poshtë cituar:

2.3.8 Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qera një kamionçinë me kapacitet mbajtës minimumi deri në 1,5 ton, si dhe 2 (dy) kamiona me vëç me kapacitet mbajtës minimumi nga 5 ton -10 ton për secilin kamion.

Per te vertetuar keto mjete duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksën vjetore. Për mjetet me qera duhet të shoqërohet me kontratën perkatese te qerase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi shoqëruar me dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksën vjetore. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne

pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik MUHOPLUS LTD ka paraqitur në sistemin elektronik kontratë qeraje datë 11.06.2018 lidhur me shoqërinë SINGS&ROAD SAFETY.

Nga shqyrtimi i kontratës së paraqitur nga operatori ekonomik vërehet se shoqëria SINGS&ROAD SAFETY i jep me qera mjetet e mëposhtme me këto të dhëna:

1.Mjetin me targë AA254EN

2. Mjetin me targë AA349AO

3.Mjetin me targë AA890OC.

Referuar mjeteve të paraqitura përkatësisht 2 mjeteve **2 (dy) kamiona me vinç me targa AA349AO dhe mjetin me targë AA254EN** konstatohet si më poshtë vijon:

Komisioni i vleresimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për mjetin me targë **AA349AO** gjykon se në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në lejen e qarkullimit referuar pesha, përfaqeson pesha kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plote të mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar lejes së qarkullimit të mjetit ku pesha Bruto është 24000 kg ose 24 ton dhe pesha neto 12 300 kg ose 12,3 ton vihet re se kapaciteti mbajtës është 11,7ton, për kamionin me targë **AA349AO** gjykon se në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në lejen e qarkullimit referuar pesha, përfaqeson pesha kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plote të mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar lejes së qarkullimit të mjetit ku pesha Bruto është 24000 kg ose 24 ton dhe pesha neto 12 300 kg ose 12,3 ton vihet re se kapaciteti mbajtës është 11,7ton.
Pra, sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me makineritë ku kerkohen 2 mjet transporti me kapacitet mbajtës nga **5 ton -10 ton**. Përsa më sipër operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me makineritë ku kerkohen 2 (dy) mjet transporti me kapacitet mbajtës nga **5 ton deri në 10 ton**.

Po kështu për mjetin me targa **AA254EN** pas shqyrtimit të dokumentacionit në S.P.E të paraqitur për mjetin me targë **AA254EN** gjykon se në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në lejen e qarkullimit referuar pesha, përfaqeson pesha kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plote të mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar lejes së qarkullimit të mjetit ku pesha Bruto është 26000 kg ose 26 ton dhe pesha neto 12600 kg ose 12,6 ton vihet re se kapaciteti mbajtës është 13,4 ton, për kamionin me targë **AA254EN** gjykon se në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në lejen e qarkullimit referuar pesha, përfaqeson pesha kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plote të mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij

dhe referuar lejes së qarkullimit të mjetit ku pesha Bruto është 26000 kg ose 26 ton dhe pesha neto 13,400 kg ose 13,4 ton vihet re se kapaciteti mbajtës është 13,4 ton.

Pra, sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshën e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”

Përsa më sipër operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me makinerite ku kerkohen 2 mjet transporti me kapacitet mbajtës nga **5 ton -10 ton**. Përsa më sipër operatori ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me makinerite ku kerkohen 2 (dy) mjet transporti me kapacitet mbajtës nga **5 ton deri në 10 ton** çka bie në kundërshtim me kriteret e kërkuara në DST.

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga “MUHOPLUS LTD” shpk, lidhur me pikën 2.3.8 mbi disponimin e mjeteve të transportit, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të percaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga operatori ekonomik **“Muhoplus LTD ” shpk** hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.15840, Prot. datë 18.06.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **” Blerje Tuba dhe Rakorderi”**

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 13323/8 Prot. dt. 18.06.2018, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 13323/9 Prot. datë 18.06.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “MUHOPLUS LTD” sh.p.k ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues.

Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatorit Ekonomik **“MUHOPLUS LTD” shpk** me ane të shkresës Nr. 15840/1 datë 19.06.2018 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 02.07.2018, me anë të shkresës nr. 13323/10, është hequr pezullimi i Urdhërit pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“ALBPLAST” sh.p.k**, se oferta me një vlerë të përgjithshme prej 62.336.661 (gjashtëdhjetë e dy milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sha, a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë me nr tel: + 355 4 2225572, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes /publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.06.2018

Ankesa: PO (Paraqitur nga operatori ekonomik **“MUHOPLUS LTD” shpk** prot hyrës 15840 datë 18.06.2018. Operatorit ekonomik i është kthyer përgjigje më datë 19.06.2018.